
THE STATE AS A SPECIFIC ORGANISATION OF SOCIETY: STATE ORGANISATION OF NORTH MACEDONIA

Lindita Neziri

Mother Teresa University, Republic of North Macedonia, lindita.neziri@unt.edu.mk;
lindita_neziri@outlook.com

Abstract: The term organisation means a social unit that includes many people who perform structured and clear activities, co-operate on the basis of defined relationships, and by co-ordinating their actions aim to achieve common goals.

There are different types of organisations which are differentiated by the purpose for which they were established, the size, volume, and complexity of their work, etc. Even the state is considered an organisation (political-legal organisation). The state is a large and complex organisation. The political-legal character, organisation, constitutive elements, diversity of bodies (institutions), the large volume of work, and their complexity are just some of the characteristics that differentiate the state from other organisations in society. The disposal of the apparatus of physical violence (monopoly of physical force) and public power are exclusive features of the state that are not found in any other organisation in society.

The basic elements in the composition of state organisations are the state bodies. The state as a large and complex organisation in society is characterised by diverse bodies (institutions), such as the president, the government, the parliament, the ministries, the courts, the ombudsperson, the public prosecutor, etc. Each state body implements state power independently and performs certain functions, while their establishment and competencies are determined by the constitution and by positive laws.

The organisation of power represents the core of the constitutional and political system both in the horizontal dimension (which means the relations of the institutions of the same level) and the vertical dimension (which means the relations of the central institutions with those of lower levels).

The highest state bodies are the legislative body (Parliament), the executive body (Government and President) and the judicial bodies (Courts).

This study deals with and analyses the organisation of the state in the political system of the Republic of North Macedonia.

For this study, we have been used: descriptive-comparative method, doctrinal research, and analysis of positive legislation.

This study concludes with suggestions that will contribute to the advancement of democracy in the country.

Keywords: North Macedonia, Constitution, President, Government, Assembly

SHTETI SI ORGANIZATË SPECIFIKE E SHOQËRISË. ORGANIZIMI SHTETËROR I MAQEDONISË SË VERIUT

Lindita Neziri

Universiteti “Nënë Teresa”, Republika e Maqedonisë së Veriut, Lindita.neziri@unt.edu.mk;
lindita_neziri@outlook.com

Abstrakt: Termi organizatë nënkupton një njësi shoqërore që përfshin shumë persona të cilët kryejnë aktivitete të strukturuar e të qarta, bashkëpunojnë në bazë të marrëdhënive të përcaktuara dhe duke koordinuar veprimet e tyre synojnë të realizojnë qëllime të përbashkëta.

Egzistojnë lloje të ndryshme të organizatave të cilët dallojnë për nga madhësia, vëllimi dhe ndërlikueshmëria e punëve, qëllimi për të cilin janë themeluar, etj. Edhe shteti konsiderohet një organizatë (organizatë politiko-juridike). Shteti është organizatë e madhe dhe komplekse. Karakteri politik, organizimi, elementet konstituive, larmishmëria e organeve (institucioneve), vëllimi i madh i punëve dhe ndërlikueshmëria e tyre janë vetëm disa nga karakteristikat që diferencojnë shtetin si organizatë nga organizatat tjera në shoqëri. Disponimi me aparatit e dhunës fizike (monopoli i forcës fizike) dhe pushteti publik janë vecori ekskluzive të shtetit që nuk hasen në asnjë organizatë tjetër në shoqëri.

Republika e Maqedonisë së Veriut si një shtet me demokraci parlamentare në aspektin teorik-normativ i respekton të gjitha parimet e organizimit të pushtetit shtetëror, duke filluar nga ndarja e pushtetit në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor; kontrollit dhe ndërveprimet të pushtetit, rregullimit me ligj të të drejtave dhe kompetencave të

institucioneve të pushtetit, etj. Organizimi i pushtetit paraqet palcën e sistemit kushtetues dhe politik si në dimensionin horizontal (që nënkupton raportet e institucioneve të po të njëjtit nivel) dhe dimenzionit vertikal (që nënkupton raportet e institucioneve qendrore me ata të niveleve më të ulta).

Elementet themelor në përbërjen e organizatës shtetërore janë organet shtetërore. Çdo organ shtetëror zbaton pushtetin shtetëror në mënyrë të pavarur dhe kryen funksione të caktuara. Themelimi dhe kompetenca e tyre përcaktohet me Kushtetutë dhe me ligje pozitive. Organet më të larta shtetërore janë: organi ligjvënës (Kuvendi), organi ekzekutiv (Qeveria dhe Presidenti) dhe organet gjyqësore (Gjykatat).

Punimi trajton organizimin e pushtetit shtetëror në sistemin politik të RMV-së, më konkretisht rolin dhe raportet mes organeve të larta shtetërore (Kuvendi, Qeveria dhe Presidenti).

Në punim përdoren: metoda deskriptive-krasuese, kërkimi doktrinar si dhe analizë e legjislacionit pozitiv.

Punimi përfundon me sugjerime që do të kontribuojnë në avancimin e demokracisë në vend.

Fjalë kyce: Maqedonia e Veriut, Kushtetuta, Presidenti, Qeveria, Kuvendi.

1. HYRJE

Shteti është organizatë me organizim më të lartë në shoqëri, është një organizatë specifike që dallohet nga organizatat tjera për shkak të disa vecorive nga të cilët më e rëndësishme është pushteti shtetëror dhe disponimi me monopolin e dhunës fizike (forcën më të organizuar brenda vendit).

Shteti si organizatë e madhe dhe komplekse në shoqëri, karakterizohet nga organe (institucione) të larmishme si: Presidenti, Qeveria, Kuvendi, Ministritë, Gjykatat, Avokati i Popullit, Prokurori Publik etj. Cdonjëra nga ta është e specializuar për kryerje të detyrave të cilat janë të caktuara me Kushtetutë dhe ligje pozitive të vendit.

Republika e Maqedonisë së Veriut (më tutje RMV), cilësohet shtet me demokraci parlamentare (sistem politik ku shumica vendos). Pushteti shtetëror ndahet në pushtetin ekzekutiv, ligjvënës, dhe gjyqësor. Ato janë të ndara dhe të pavarura nga njëra-tjetra. Bartës i pushtetit ligjvënës është Kuvendi si organ përfaqësues i qytetarëve, bartës i pushtetit ekzekutiv është Qeveria dhe Presidenti (rol ceremonial), kurse bartës të pushtetit gjyqësor janë Gjykatat. Në aspektin kushtetues, egziston një lloj baraspeshe mes pushteteve legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Punimi përfshin tri pjesë: pjesa e parë trajton organizimin e Kuvendit si bartës i pushtetit ligjvënës në vend, në pjesën e dytë analizohet organizimi i Qeverisë dhe Presidentit si bartës të pushtetit ekzekutiv, kurse në pjesën e tretë në pika të shkurtra trajtohet roli i Gjykatave si bartës të pushtetit gjyqësor.

Pyetja e hulumtimit është: *Si është organizimi shtetëror në sistemin politik të RMV-së?*

2. KUVENDI SI BARTËS I PUSHTETIT LIGJVËNËS NË SISTEMIN POLITIK TË RMV-SË

Kuvendi njihet si “tempulli i demokracisë” dhe vendi ku buron sovraniteti popullor (Bajrami & Mucaj, 2018: 337). Kuvendi është unikameral (njëdhomësh), trup konstitutiv, ligjvënës dhe organ përfaqësues i qytetarëve. Funksionimi dhe organizimi i tij rregullohet me aktin më të lartë juridik në vend - Kushtetutën si dhe me Rregulloren dhe Ligjin për Kuvendin.

Detyra kryesore është të miratojë aktet më të larta ligjore në vend (Kushtetutën dhe ligjet) të detyrueshme për të gjithë qytetarët e vendit. Kuvendi përbëhet nga deputetët, nga rradha e të cilëve zgjidhet Kryetari i Kuvendit i cili e përfaqëson Kuvendin (Kushtetuta, neni 67).

Aktualisht, mënyra, kushtet dhe procedura për zgjedhjen e deputetëve rregullohet me Kushtetutë dhe Kodin Zgjedhor të vitit 2006. Korniza ligjore përfshin edhe: Kodin Penal të vitit 1996, Ligjin për partitë politike të vitit 2004, Ligjin për Financimin e Partive Politike të vitit 2004, Ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike të vitit 2013 si dhe udhëzimet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (Neziri, 2022:17-22).

Sipa Kodit Zgjedhorë, kandidat për deputet, mund të jetë çdo shtetas i RMV-së që ka mbushur 18 vjet; ka aftësi pune; nuk vuan dënim për ndonjë vepër penale për të cilën kumtohet vuajtje e dënimit me burg në afat prej 6 muajsh. (neni 7). Deputetët zgjidhen sipas modelit zgjedhor proporcional me lista të mbyllura, territori i shtetit ndahet në gjashtë njësi zgjedhore dhe në çdo njësi zgjidhen nga 20 deputetë, kurse tre deputetë zgjidhen sipas modelit të shumicës dhe atë nga një deputet nga tre njësitë zgjedhore: në Amerikën Veriore dhe Jugore; në Evropë dhe Afrikë; dhe në Australia dhe Azi.

Kushtetuta përcakton kompetencat kryesore të Kuvendit. Kuvendi ka këto kompetenca: *“nxjerr dhe ndryshon Kushtetutën, nxjerr dhe bën interpretimin autentik të ligjeve, përcakton detyrimet publike, nxjerr Buxhetit dhe llogarinë përfundimtare të Buxhetit, nxjerr planin hapësinor të Republikës, ratifikon marrëveshje ndërkombëtare vendos për luftë dhe paqe, merr vendim për ndryshimin e kufijve të Republikës, merr vendim për aderim dhe dalje nga aleanca ose bashkësia me shtetet e tjera, shpall referendum, zgjedh Qeverinë, zgjedh gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, bën zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve, bën zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin edhe të bartësve të tjerë të funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, ushtron kontroll*

dhe mbikëqyrje politike mbi Qeverinë dhe mbi bartësit e tjerë të funksioneve publike të cilët përgjigjen para Kuvendit dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë” (neni 68).

Nëqoftëse dyshohet për keqpërdorim të kompetencave nga Presidenti apo shkelje të Kushtetutës, Kuvendit i mundësohet marrja e iniciativës për ndërprerje të parakohshme të mandatit të Presidentit, gjithsesi fjalën e fundit e ka Gjykata Kushtetuese.

3. PRESIDENTI DHE QEVERIA SI BARTËSE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV

Presidenti cilësohet si një “pushtet asnjëanës” që nuk përfshihet në lojën politike, dhe nuk kryen ndonjë funksion aktiv në realizimin dhe përcaktimin e drejtimit politik. Në pikëpamje protokollare konsiderohet organ më i lartë shtetëror, që nuk i nënshtrohet urdhrave apo kontrollit nga organet tjera, megjithatë është i detyruar të respektojë dhe të mbrojë Kushtetutën dhe ligjet. Roli kryesor i tij është ushtrimi i unitetit të popullit që arrihet përmes vendimeve të mira në të mirë të qytetarëve, neutralitetit ndaj partive politike dhe sigurimit të funksionimit normal të sistemit kushtetues.

Presidenti është përfaqësues i gjithë qytetarëve të vendit pa marrë parasysh përkatësinë e tyre politike, etnike, fetare etj. Si bartës i pushtetit ekzekutiv ka një pozitë karakteristike për të gjitha shtetet me demokraci parlamentare, ka rol ceremonial dhe është nën “hijen” e Qeverisë.

Presidenti gëzon imunitet, nuk përgjigjet për punën e tij para asnjë organi, megjithatë Presidenti nuk qëndron përmbi ligjin dhe Kushtetutën, përkundrazi edhe ai përgjigjet në raste të parapara me ligje. Legjitimiteti i Presidentit fitohet drejtpërsëdrejti nga vota e lirë e qytetarëve të RMV-së, megjithatë roli i tij dallon në krahasim me vendet me sistem presidencial apo gjysmëpresidencial ku zgjedhja e Presidentit bëhet drejtpërsëdrejti nga qytetarët.

RMV, bën pjesë në grupin e shteteve me sistem politik parlamentar, megjithatë modeli kushtetues i organizimit të pushtetit shtetror në vend, nuk mund të përkufizohet si sistem parlamentar i formës së pastër. Kushtetuta ka marrë disa elemente nga sistemi presidencial dhe disa elemente nga sistemi parlamentar. Nga sistemi presidencial ka marrë: zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit të vendit, veton suspensive ndaj ligjeve që i sjell Kuvendi me shumicë të thjeshtë dhe absolute të votave nga deputetët si dhe përgjegjësinë e Presidentit për shkeljen e ligjeve dhe Kushtetutës. Nga sistemi parlamentar janë marrë: ushtrimi i pushtetit ekzekutiv nga 2 organe (Presidenti dhe Qeveria) si dhe ekzistimi i bashkepunimit midis legjislativit dhe ekzekutivit (Neziri, 2021: 251-252).

Sipas Kushtetutës, Presidenti zgjidhet sipas sistemit zgjedhor të shumicës (mazhoritar) dy raundësh, për një mandat prej 5 vitesh (neni 81). Zgjedhjet organizohen në tërë teritorin e shtetit dhe në përfaqësitë diplomatike – konsullore (Amerikë Veriore dhe Jugore, Evropë dhe Afrikë; Australi dhe Azi), si një njësi zgjedhore sipas modelit të shumicës (neni 4, alinea 1.).

Sipas Kushtetutës, kandidaturë për President të Republikës mund të paraqes cdo shtetas i RMV-së, që është banor i RMV-së së paku 10 vitet e fundit; ka mbushur 40 vjet, si dhe në 15 vitet e fundit nuk ka qenë i zgjedhur paraprakisht dy herë në funksionin President (neni 80). “Kandidatin duhet ta propozojnë së paku 10 000 zgjedhës të regjistruar në Listën zgjedhore ose 30 deputetë” (neni 81).

President zgjidhet kandidati që fiton shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Listën e zgjedhësve. Nëse në rrethin e parë asnjëri nga kandidatët për President nuk fiton shumicën e nevojshme të votave, atëherë në afat brenda katërmbëdhjet ditësh organizohet rrethi i dytë zgjedhor ku votohet për dy kandidatë të cilët në rrethin e parë kanë marrë shumicën e votave. Për President zgjidhet kandidati që merr shumicën e votave nga zgjedhësit që kanë votuar, në qoftë se kanë votuar më shumë se 40% e zgjedhësve. Në qoftë se edhe në balotazh asnjë nga kandidatët nuk fiton shumicën e nevojshme, përsëritet gjithë procedura e votimit (neni 81).

Sipas Kushtetutës, Presidenti kryen këto kompetenca: “*cakton mandatarin për formimin e Qeverisë emëron dhe revokon me dekret ambasadorët dhe përfaqësuesit e RMV-së jashtë vendit, pranon letrat kredenciale dhe revokuese të përfaqësuesve të huaj diplomatikë, propozon dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, propozon dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor Republikan, emëron tre anëtarë të Këshillit për Siguri të Republikës së Maqedonisë, i propozon anëtarët e Këshillit për Marrëdhënie Ndëretnike, emëron dhe shkarkon edhe bartës të tjerë të funksioneve shtetërore dhe publike të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, ndan dekorata dhe mirënjohje në përputhje me ligjin, bën faljen në përputhje me ligjin dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me Kushtetutë” (neni 84).*

Qeveria është bartësja kryesore e pushtetit ekzekutiv.

Qeverinë e përbën kryeministri dhe një numër i caktuar i ministrave. Mandati për formimin e Qeverisë i ofrohet liderit të partisë që ka fituar në zgjedhjet parlamentare i cili obligohet që në afat prej 20 ditësh të paraqes programin dhe përbërjen e Qeverisë përpara Kuvendit. Në qoftë se lideri i partisë fitimtare në zgjedhje nuk arrin ta formoj Qeverinë atëher Presidenti mandatin për formimin e Qeverisë ia ofron partisë së dytë për nga numri i deputetëve (Aziri, 2012: 243). Qeverinë e formon partia që ka fituar zgjedhjet dhe ka kapacitet të siguroj shumicën parlamentare, Qeveria zgjidhet me shumicën e votave të përbërjes parlamentare. Kuvendi voton për secilin ministër

të propozuar vec e vec që teorikisht ka mundësi që ndonjëri nga kandidatët për ministër të mos zgjidhet që drejtpërdrejt e rrezikon autoritetin e mandatarit. Qeveritë e RMV-së zakonisht janë qeveri të koalicionit, mandati Qeverisë zgjat 4 vjet aq sa zgjat edhe mandati i përbërjes së Kuvendit. Mandati i Qeverisë si tërësi mund të ndërpritet edhe më herët nëse Kuvendi i shpreh mosbesim Qeverisë, nëse Qeveria jep dorëheqje, nëse Kryeministri jep dorëheqje, nëse Kryeministri vdes ose ka ndalesë të përhershme ta ushtroj funksionin e kryeministrit. Në rast se Kryeministri insiston të ndryshoj 1/3 e përbërjes qeveritare veprohet sikurse të zgjidhet qeveria e re.

Momentalisht, RMV ka 16 Ministri. Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Ekonomisë; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Financave; Ministria e Transportit dhe Lidhjeve; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Vetëqeverisjes Lokale; Ministria e Kulturës; Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive.

Qeveria dhe gjithë anëtarët e saj përgjigjen para Kuvendit.

Sipas Kushtetutës, Qeveria kryen këto funksione: *“cakton politikat e zbatimit të ligjeve dhe rregullave të Kuvendit si dhe mban përgjegjësi për zbatimin e tyre; propozon ligje, Buxhetin dhe rregulla tjera që i miraton Kuvendi; propozon vendime për rezervat e Republikës dhe kujdeset për realizimin e tyre; propozon planin hapësinor të Republikës, miraton urdhëresat dhe rregulla të tjera për zbatimin e ligjeve; cakton parimet për organizimin e brendshëm dhe për punën e ministrive dhe organeve të tjera të administratës, orienton dhe bën mbikëqyrje mbi punën e tyre; jep mendime për projektligje dhe rregulla tjera të cilat Kuvendi ia paraqesin propozuesit e tjerë të autorizuar; vendos për njohjen e shteteve dhe qeverive; vë marrëdhënie diplomatike dhe konsullore me shtetet e tjera; merr vendime për hapjen e përfaqësive diplomatike-konsullore jashtë vendit, propozon emërimin e ambasadorëve dhe përfaqësuesve të RMV-se jashtë vendit dhe emëron shefat e përfaqësive konsullore; propozon Prokuror Publik; bën emërimet dhe shkarkimet të bartësve të funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj”* (neni 91).

4. GJYKATA SI BARTËSE E PUSHTETIT GJYQËSOR

Organizimi i gjyqësisë është unik. Llojet, themelimi, kompetencat, organizimi dhe përbërja e gjykatave si dhe procedura para tyre rregullohen me ligj, i cili miratohet me shumicë të cilësuar (2/3 e votve nga numri i përgjithshëm i deputetëve).

Për dallim nga pushteti ligjvënës dhe pushteti ekzekutiv, të cilët legjitimitetin e tyre e fitojnë në zgjedhje të drejtpërdrejta nga votuesit, me pushtetin gjyqësor punët qëndrojnë ndryshe. Gjykatësit kanë mandat të pakufizuar, zgjidhen njëherë dhe janë përgjegjës vetëm para ligjit.

Parimet bazë kushtetuese mbi të cilat ndërtohet sistemi gjyqësor kanë të bëjnë me pavarësinë, autonominë si dhe ligjshmërinë. Pavarësia dhe autonomia e gjyqeve është parakusht kryesor për gjykim objektiv dhe të paanshëm.

Funksionet e pushtetit gjyqësor përfshijnë: zbatim të paanshëm të drejtës, mbrojtje, respektim dhe përparim të drejtave dhe lirive themelore; barazi dhe mosdiskriminim; garancë e siguri juridike në bazë të sundimit të së drejtës.

Pushtetin gjyqësor në RMV e ushtrojnë gjykatat: Themelore, e Apelit, Administrative dhe Gjykata Supreme.

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

RMV, si një shtet me demokraci parlamentare i respekton të gjitha parimet që i nënkupton kjo formë e organizimit të pushtetit shtetëror duke filluar nga ndarja e pushtetit, kontrollit dhe ndërveprimit të pushteteve, rregullimin me ligj të të drejtave dhe kompetencave të institucioneve të pushtetit, etj.

Në aspektin kushtetues, egziston një lloj baraspeshe mes pushteteve (legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit) megjithatë përsëri ndjehet një epërsi e ekzekutivit përballë dy pushteteve tjera.

Gjatë analizës së rolit të organeve shtetërore ajo që bie në sy është është kompleksiviteti i Qeverisë në raport me Presidentin për sferat ku të dy institucionet kanë kompetenca dhe nuk janë qartë të definuara e këto janë mbrojtja dhe punët e jashtme. Përputhja e kompetencave mund të paraqet problem në rastet kur Presidenti i Republikës nuk i takon koalicionit qeveritar, gjegjësisht partisë që udhëheq koalicionin qeveritar, andaj kjo çështje duhet të analizohet më tej.

Duke pasur parasysh faktin që RMV është shtet multi-etnik, e konsiderojmë të nevojshme që me dispozita kushtetuese dhe ligjore të parashihet edhe posti i Zëvendës-presidentit të shtetit si dhe të ndërtohen mekanizma të nevojshëm që ai post me cdo kusht t’ju takojë etniteteve jomaqedonase në vend. Kjo mund të ketë ndikim pozitiv.

LITERATURA E SHFRYTEZUAR

- Aziri, E. (2012). *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë: formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, UEJL, Tetovë.
- Bajrami, F. & Mucaj, F. (2018), *E drejta kushtetuese*, Prishtinë, fq.337-, fq. 381-409, fq. 411-415.
- Davitkovski, B. & Pavlovska- Daneva (2018) *E drejta administrative*, Shkup, fq. 95-96.
- Kuculovska, R. & Sotiroska, V. & Grnçarevski, V. (2022), Shkup, “*E drejta dhe rregullimi shtetëror*” fq. 52-57, e disponueshme online <https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf>
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut me amendamentet e Kushtetutës I-XXX, e disponueshme online në: <http://www.sobranie.mk>
- Kodi Zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11
- Maksuti, M. (2010). *E drejta kushtetuese e Republikës së Maqedonisë*, Tetovë, fq.150-195.
- Musliu, A. (2022), *Reformat e Sistemit Zgjedhor në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, Centrum, fq.73, e disponueshme online në:<http://centrum.mk/wp-content/uploads/2022/10/Pjesa-5-1.pdf>
- Ligji për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut e disponueshme online <https://www.sobranie.mk/>
- Neziri, L. (2022), *The necessity to change the Macedonian electoral system for parliamentary elections*, në “International Dialogue: East-West” Vol.9 fq.17-21, e disponueshme online në https://konferencii.msu.edu.mk/wp-content/uploads/000-Pravo-i-Politikologija-2022_book-FINAL.pdf
- Neziri, L. (2021), *Analysis of the electoral system for presidential elections in the Republic of North Macedonia: advantages and disadvantages*, në Knoëlegde- International Journal, Vol 51.1, fq. 251-256, e disponueshme online në:<https://ikm.mk/ojs/index.php/kij/article/view/5061/5038>.
- Pankovski, M. & Mladenovska, S., (2019). *Manual për zgjedhje presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, botimi i dytë i plotësuar, Institutit për Demokraci “Societas Civilis” – Shkup, fq.19-25.
- Pollozhani, B. (2001). Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës, fq. 54-57.
- Pollozhani, B. & Mucaj,F. (2018). *E drejta kushtetuese*, Prishtinë, fq.380-401.
- Rregullore e punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, 2008, e disponueshme online në: <https://www.sobranie.mk>.
- Shasivari, J. (2020), “*E Drejta Kushtetuese*” Skopje, fq. 272-273.